



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 709/ prot.
16

Elbasan, me 20.03.2025

VENDIM

Nr 12, datë 20.03.2025


Për

**vendosjen e tarifave të konkurrimit, tarifave të regjistrimit, tarifave të shkollimit
në të gjitha programet e studimit në Universitetin e Elbasanit "Aleksandër
Xhuvani"**

Në mbështetje të Ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", neni nr. 3. Pika 3. ç), neni nr. 6, neni nr. 47, VKM nr. 288 datë 21.05.2018 "Për miratimin e kufirit maksimal të tarifës vjetore të shkollimit për studentët që ndjekin studimet në institucionet publike të arsimit të lartë, në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale me kohë të plotë", i ndryshuar me VKM nr. 778 datë 26.12.2018, shkresës së MASR nr. 1036 prot, datë 06.02.2020 "Mbi zbatimin e VKM-së nr. 778, datë 26.12.2018", Vendimit të Senatit Akademik nr. 34, datë 17.03.2025, "Për vendosjen e tarifave të konkurrimit, tarifave të regjistrimit, tarifave të shkollimit në të gjitha programet e studimit në Universitetin e Elbasanit 'Aleksandër Xhuvani'", Bordi i Administrimit,

VENDOSI:

1. Tarifa konkurrimi të jetë në vlerën 5,000 Lek për aplikant për konkuruesit në Ciklin e parë të studimeve "Bachelor në edukim fizik e sporte".
2. Tarifë regjistrimi:
 - a. **Tarifa e regjistrimit** në programet me karakter profesional – Pkpr, programet e ciklit të parë të studimeve bachelor - Bach, programet e integruara master i shkencave – PiMs **të jetë në vlerën 1,600 Lek**. Këtë tarifë e paguan çdo kandidat që del fitues dhe regjistrohet në një program studimi në UE.
 - ❖ Tarifa e regjistrimit që paguhet nga kandidatët për student, të cilët regjistrohen në një program studimi në UE, por që çregjistrohen në një fazë të mëvonshme nga ky program studimi, për tu regjistruar në një program tjetër brenda UE – së, të paguhet vetëm njëherë.
 - ❖ Tarifa e regjistrimit që paguhet nga kandidatët për student, të cilët regjistrohen në një program studimi në UE, por që çregjistrohen në një fazë të mëvonshme nga ky program studimi, për t'u regjistruar në një Universitet tjetër, do të jetë e pakthyeshme.



- b. **Tarifë aplikimi dhe regjistrimi në ciklin e dytë të studimeve;** Master profesional - Mp, Master i shkencave – Msh, Program i formimit të vazhduar – Pfv **të jetë në vlerën 2,500 Lek.**
- ❖ Tarifa e regjistrimit do të paguhet nga kandidatët për student, për secilin program që kandidati regjistrohet për konkurrim në ciklin e dytë në UE. Në momentin që del fitues në një program studimi, nuk do të ketë tarifë tjetër regjistrimi – pra kjo tarifë do të përfshij konkurrimin dhe regjistrimin.
- c. **Tarifë aplikimi dhe regjistrimi në ciklin e tretë të studimeve “Doktoratë” të jetë 5,000 Lek.** Tarifa e regjistrimit do të paguhet nga kandidatët për student, për secilin program që kandidati regjistrohet për konkurrim në ciklin e tretë në UE.
- ❖ Në momentin që del fitues në një program studimi, nuk do të ketë tarifë tjetër regjistrimi – pra kjo tarifë do të përfshijë konkurrimin dhe regjistrimin.
3. Tarifat e shkollimit për të gjitha programet e studimit:
- a) **Në programet me karakter profesional – Pkpr, programet e ciklit të parë të studimeve bachelor - Bach:**
- **Për program të parë studimi**, në programet me karakter profesional – Pkpr, programet e ciklit të parë të studimeve bachelor - Bach, **tarifa vjetore e shkollimit të jetë në vlerën 25,000 Lek.**
 - ❖ **Studentët në program të parë studimi**, në programet me karakter profesional – Pkpr, programet e ciklit të parë të studimeve bachelor - Bach, që regjistrohen **në vitin e parë akademik paguajnë tarifën vjetore të shkollimit në vlerën 12,500 Lek.**
 - ❖ **Studentët në program të parë studimi** në programet me karakter profesional – Pkpr, që studiojnë në vitin e dytë, të cilët kanë **notë mesatare të ponderuar 6 (gjashtë) e lart, në vitin akademik paraardhës**, si dhe kanë shlyer të gjitha detyrimet e vitit paraardhës akademik, për të cilin llogaritet nota mesatare e ponderuar, të paguajnë tarifën vjetore të shkollimit **në vlerën 12,500 Lek.** Studentët që rezultojnë me **notë mesatare nën 6 (gjashtë)** të paguajnë tarifën vjetore të shkollimit **në vlerën 25,000 Lek.**
 - ❖ **Studentët në program të parë studimi** në programet e ciklit të parë të studimeve bachelor - Bach, që studiojnë në vitin e dytë e të tretë, të cilët kanë **notë mesatare të ponderuar 6 (gjashtë) e lart**, në vitin akademik paraardhës, si dhe kanë shlyer të gjitha detyrimet e vitit paraardhës akademik, për të cilin llogaritet nota mesatare e ponderuar, të paguajnë tarifën vjetore të shkollimit **në vlerën 12,500 Lek.** Studentët që rezultojnë me **notë mesatare nën 6 (gjashtë)** të paguajnë tarifën vjetore të shkollimit **në vlerën 25,000 Lek.**
 - **Për program të dytë**, në programet me karakter profesional – Pkpr, programet e ciklit të parë të studimeve bachelor - Bach, **tarifa vjetore e shkollimit, tarifa vjetore e shkollimit të jetë në vlerën 60,000 Lek.**
- b) **Në programe të integruar të studimeve master i shkencave – PiMs**, **tarifa vjetore e shkollimit të jetë:**
- **Për program të parë studimi** në programet e integruara master i shkencave – PiMs **tarifa vjetore e shkollimit të jetë në vlerën 30,000 Lek.**
 - ❖ **Studentët në program të parë studimi** në programet e integruara master i shkencave – PiMs, që regjistrohen **në vitin e parë akademik** të paguajnë tarifën vjetore të shkollimit **në vlerën 15,000 Lek.**



- ❖ **Studentët në program të parë studimi** në programet e integruara master i shkencave – PiMs, që studiojnë në vitin e dytë, të tretë, të katërt e të pestë, të cilët kanë **notë mesatare të ponderuar 6 (gjashtë) e lart**, në vitin akademik paraardhës, si dhe kanë shlyer të gjitha detyrimet e vitit paraardhës akademik, për të cilin llogaritet nota mesatare e ponderuar, të paguajnë tarifën vjetore të shkollimit në vlerën 15,000 Lek. Studentët që rezultojnë **me notë mesatare nën 6 (gjashtë)** të paguajnë tarifën vjetore të shkollimit në vlerën 30,000 Lek.
 - **Për program të dytë studimi** në programet e integruara master i shkencave – PiMs tarifa vjetore e shkollimit **të jetë në vlerën 60,000 Lek.**
 - c) **Në programe të ciklit të dytë të studimeve “Master profesional - Mp”,** tarifa për çdo kredit të jetë:
 - Për program të parë studimi në vlerën **1,000 Lek/kredit.**
 - Për program të dytë studimi në vlerën **1,200 Lek/kredit.**
 Tarifa e përgjithshme e shkollimit për çdo program studimi të jetë:
 - Për program të parë studimi:
 - Në programet e studimit me 60 kredite tarifa e përgjithshme në vlerën **60,000 Lek.**
 - Në programet e studimit me 120 kredite tarifa e përgjithshme në vlerën **120,000 Lek.**
 - Për program të dytë studimi:
 - Në programet e studimit me 60 kredite tarifa e përgjithshme në vlerën **72,000 Lek.**
 - Në programet e studimit me 120 kredite tarifa e përgjithshme në vlerën **144,000 Lek.**
 Studentët në program të dytë studimi nuk paguajnë për kreditet e lëndëve që njihen me vendim të njësisë bazë, nëse studenti nuk i shlyen detyrimet e krediteve të njohura.
 - d) **Në programe të ciklit të dytë të studimeve “Master i shkencave - Msh”,** tarifa për çdo kredit të jetë:
 - Për program të parë studimi në vlerën **1,200 Lek/kredit.**
 - Për program të dytë studimi në vlerën **1,400 Lek/kredit.**
 Tarifa e përgjithshme e shkollimit për çdo program studimi të jetë:
 - Për program të parë studimi tarifa e përgjithshme në vlerën **144,000 Lek.**
 - Për program të dytë studimi tarifa e përgjithshme në vlerën **168,000 Lek.**
 Studentët në program të dytë studimi nuk paguajnë për kreditet e lëndëve që njihen me vendim të njësisë bazë, nëse studenti nuk i shlyen detyrimet e krediteve të njohura.
 - **Në programin e formimit të vazhduar – Pfv** tarifa për çdo kredit të jetë vlerën **1,000 Lek/kredit.** Tarifa e përgjithshme e shkollimit për programin e formimit të vazhduar të jetë në vlerën **35,000 Lek**
 - e) **Tarifa e shkollimit për projektet e trajnimeve të jetë:**
 - Për trajninin e **mësuesve të arsimit parauniversitar** - Tarifë trajnimi në vlerën **1,000 Lek/modul.**
 - Për trajninin e **personelit shëndetësor (Mjek, Infermier)** - Tarifë trajnimi në vlerën **1,000 Lek/modul.**
 - f) **Në programe të ciklit të tretë të studimeve “Doktoratë”,** tarifa e përgjithshme **të jetë 450,000 Lek** dhe të paguhet me kështë të barabartë me nga 150,000 Lek për tre vitet e para të studimeve:
4. **Studenti i shpallur përsëritës** në programet me karakter profesional – Pkpr, programet e ciklit të parë të studimeve bachelor - Bach, programet e integruara master i shkencave – PiMs, sipas rregullores së Universitetit;



- a) **Në programet me karakter profesional – Pkpr**, i shpallur përsëritës në vitin e parë dhe vitin e dytë (nuk ka marrë 20 kredite për të kaluar në vitin pasardhës):
- **Për program të parë studimi** tarifa vjetore e shkollimit të jetë në vlerën **25,000 Lek.**
 - **Për program të dytë studimi** tarifa vjetore e shkollimit të jetë në vlerën **60,000 Lek.**
- b) **Në programet e ciklit të parë të studimeve bachelor - Bach**, i shpallur përsëritës në vitin e parë, vitin e dytë dhe vitin e tretë (nuk ka marrë 20 kredite për të kaluar në vitin pasardhës), të paguajë:
- **Për program të parë studimi** tarifa vjetore e shkollimit të jetë në vlerën **25,000 Lek.**
 - **Për program të dytë studimi** tarifa vjetore e shkollimit të jetë në vlerën **60,000 Lek.**
- c) **Në programet e integruar të studimeve master i shkencave – PiMs**, i shpallur përsëritës në vitin e parë, vitin e dytë, vitin e tretë, vitin e katërt dhe vitin e pestë (nuk ka marrë 20 kredite për të kaluar në vitin pasardhës), të paguajë:
- **Për program të parë studimi** tarifa vjetore e shkollimit të jetë në vlerën **25,000 Lek.**
 - **Për program të dytë studimi** tarifa vjetore e shkollimit të jetë në vlerën **60,000 Lek.**
5. **Studenti që nuk përfundon studimet** në programet me karakter profesional – Pkpr, programet e ciklit të parë të studimeve bachelor - Bach, programet e integruara master i shkencave – PiMs;
- a) **Në programet me karakter profesional – Pkpr në fund vitit të dytë** (ka marrë 40 kredite nga viti i parë dhe ka marrë 20 kredite nga viti i dytë), nuk do të paguajë tarifë shkollimi si student përsëritës i vitit të dytë, por do të paguajë tarifën e krediteve të mbartura, vetëm për lëndët e vlerësuara me notë jo kaluese në përfundim të vitit akademik të fundit (gjendje në regjistrin themeltar me 30 shtator):
- **për program të parë studimi** tarifa e krediteve të mbartura të jetë në vlerën **400 Lek/kredit,**
 - **për program të dytë studimi** tarifa e krediteve të mbartura të jetë në vlerën **1,000 Lek/kredit.**
- b) **Në programet e ciklit të parë të studimeve bachelor - Bach në fund vitit të tretë** (ka marrë 40 kredite nga viti i parë, ka marrë 40 kredite nga viti i dytë dhe ka marrë 20 kredite nga viti i tretë), nuk do të paguajë tarifë shkollimi si student përsëritës në vitin tretë, por do të paguajë tarifën e krediteve të mbartura, vetëm për lëndët e vlerësuara me notë jo kaluese në përfundim të vitit akademik të fundit (gjendje në regjistrin themeltar me 30 shtator):
- **për program të parë studimi** tarifa e krediteve të mbartura të jetë në vlerën **400 Lek/kredit,**
 - **për program të dytë studimi** tarifa e krediteve të mbartura të jetë në vlerën **1,000 Lek/kredit.**
- c) **Në programet e integruara master i shkencave – PiMs në fund të vitit të pestë** (ka marrë 40 kredite nga viti i parë, ka marrë 40 kredite nga viti i dytë, ka marrë 40 kredite nga viti i tretë, ka marrë 40 kredite nga viti i katërt dhe ka marrë 20 kredite nga viti i pestë), nuk do të paguajë tarifë shkollimi si student përsëritës në vitin pestë, por do të paguajë tarifën e krediteve të mbartura, vetëm për lëndët e vlerësuara me notë jo kaluese në përfundim të vitit akademik të fundit (gjendje në regjistrin themeltar me 30 shtator):
- **për program të parë studimi** tarifa e krediteve të mbartura të jetë në vlerën **500 Lek/kredit,**
 - **për program të dytë studimi** tarifa e krediteve të mbartura të jetë në vlerën **1,000 Lek/kredit.**



6. Studenti i Ciklit të dytë të studimeve që nuk përfundon studimet brenda kohëzgjatjes së caktuar do të paguajë tarifën e krediteve të mbartura vetëm për lëndët e vlerësuara me notë jo kaluese në përfundim të vitit akademik të fundit (gjendje në regjistrin themeltar me 30 shtator).
 - ❖ tarifa e krediteve të mbartura vetëm për lëndët e vlerësuara me notë jo kaluese në përfundim të vitit akademik të fundit do të paguhet, pasi të jenë shlyer detyrimet e krediteve të kohës normale të studimit (tarifën përgjithshme për 60 kredite në programet Master profesional me 60 kredite, tarifën përgjithshme për 120 kredite për programet e Master profesional dhe Master i shkencave me nga 120 kredite).
7. Vlera e krediteve të mbartura të paguhet për vlerën totale të lëndëve të vlerësuara jo kaluese, menjëherë para fillimit të sezonit të parë të shlyerjes së detyrimeve mësimore. Kreditet e lëndëve të vlerësuara jo kaluese të krijuara në vijim, pas vitit të fundit akademik (gjendje në regjistrin themeltar me 30 shtator), i shtohen detyrimeve të prapambetura dhe paguhet para shlyerjes së detyrimeve mësimore, të vitit pasardhës akademik.
8. Tarifa vjetore e shkollimit për programet me karakter profesional – Pkpr, programet e ciklit të parë të studimeve bachelor - Bach, programet e integruara master i shkencave – PiMs, të paguhet para fillimit të shlyerjes së detyrimeve mësimore të vitit akademik.
9. Tarifa vjetore e shkollimit për Ciklin e dytë të studimeve, tarifa e përgjithshme të paguhet me këste para shlyerjes së detyrimeve mësimore të çdo semestri.
10. Tarifa vjetore e shkollimit për Ciklin e tretë të studimeve “Doktoratë”, tarifa e përgjithshme të paguhet me këste të barabartë për tre vitet e para të studimeve në fillim të vitit akademik.
11. Studenti për programet me karakter profesional – Pkpr, programet e ciklit të parë të studimeve bachelor - Bach, programet e integruara master i shkencave – PiMs, që ka pezulluar studimet apo kërkon të çregistrohet (nuk ka vijuar në mësim dhe nuk ka shlyer asnjë detyrim mësimor), të mos paguajë tarifë vjetore shkollimi për këtë periudhë. Ky fakt të vërtetohet me dokument nga fakultetet.
12. Studenti i Ciklit të dytë i pajisur me numrin e matrikullimit që kërkon të çregistrohet nga ky program studimi nuk do paguajë asnjë detyrim financiar, në rast se nuk ka frekuentuar dhe nuk i është shërbyer për shlyerjen e detyrimeve mësimore. Ky fakt të vërtetohet me dokument nga fakultetet.
13. Ngarkohet Administratori i Universitetit “Aleksandër Xhuvani” për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I BORDIT
Dr. Ardian Durmishi



